

**Njoftim nga takimi i kryetarit me drejtorët e komunës
Ekzekutivi i Prizrenit miraton dhjetëra konkluzione**

28 mars 2014, Prizren

EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit "Transparenca online e komunës së Prizrenit" këtë javë ka marrë pjesë në mbledhjen e ekzekutivit të Prizrenit, i cili takim u mbajt nën drejtimin e nënkryetarit Lulzim Kabashi, ku u miratuan një varg konkluzionesh.

Në këtë takim ekzekutivi lokal i ka dhënë dritën e gjelbërt të gjitha propozimeve të Drejtorisë së Arsimit, si: shpalljen e tenderëve për hartimin e projekteve dhe ndërtimin e objekteve të reja të këtyre shkollave fillore të mesme të ulta: "Dy dëshmorët" në Piranë me 14 dhoma mësimi, "Zef Lush Marku" në Velezhë me 9 dhoma mësimi, "Ekrem Rexha" në Gënçare me 9 dhoma mësimi, sikurse shpalljen e tenderit për hartimin e projektit dhe ndërtimit të sallës së edukatës fizike të SHFMU "Haziz Tola" në Prizren, që kap vlerën rreth 750.000 euro.

Gjithashtu, bordi miratoi vendimin për furnizim me inventar shkollor për shkollat e Komunës së Prizrenit ku janë planifikuar 30.000 euro. Me 11.000 euro, në SHFMU "Emin Duraku" në Prizren do të bëhet furnizimi me pajisje sportive. Në SHFMU "Naim Frashëri" në Vlashnje do të bëhet ndërrimi i dyerve dhe dritareve me planifikim mjetesh prej 30.000 euro, në SHFMU "Hasim Maliqaj" në Polisht në shumë prej 20.000 euro do të rregullohet rrethoja e fushës sportive, sikurse rregullimi i rrethojës së oborrit të SHFMU "Brigada 125" në Medvec në shumë prej 15.000 euro dhe punimin e rrethojës së oborrit të shkollës "Pjetër Mazreku" në Konjush, me shumën prej 30.000 euro. Është miratuar njëzëri edhe konkluzioni për shpalljen e tenderëve për rregullimin e terrenit sportiv në SHFMU "Lekë Dukagjini" në Petrovë investim prej 25.000 eurove si dhe renovimin e sallës së Edukatës Fizike në SHFMU "Lekë Dukagjini" në Prizren në vlerë prej 40.000 euro.

Për 49 shkolla, përkatësisht 90 objekteve shkollore, është nxjerr konkluzioni për furnizim me lëndë djegëse. Edhe këtë vit do t'u sigurohet transporti i nxënësve udhëtar për 44 nxënës të këtyre vendbanimeve, Smaq-Velezhë dhe anasjelltas, Leskovec-Prizren dhe anasjelltas si dhe Krushë e Vogël-Prizren dhe anasjelltas. Vlera në tërësi kap shumën prej gjithsejtë 7.650 euro për periudhën janar-dhjetor 2014. Po ashtu ka kaluar kërkesa për shpalljen e konkursit për bursa studentore për vitin kalendarik 2014 ku për këtë vit priten të ndahen vetëm 80 bursa në vlerë prej 50.000 euro.

Po ashtu kësaj drejtorie i është lejuar shpallja e tenderëve për organizimin e Festivalit të Valleve Popullore, Festivalit Loja Skenike dhe Manifestimi Tradicional "Java e Remzi Ademajt". Paralogaritë për këto evente do të përfshijnë shumën e rreth 27.000 euro.

Në këtë mbledhje ekzekutivi lokal ka miratuar propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike për lejimin e mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve të rivarrimit të personave të identifikuar të fshatit Krushë të Vogël, të vrarë gjatë luftës. Po ashtu në këtë takim janë miratuar njëzëri lejimi i mjeteve nga subvencionet për shënimin e Festave Mjedisore shuma e planifikuar kap shifrën prej 8.500 euro dhe shpalljes së tenderit për Mbjelljen e fidanëve drunore dekorative në qytet.

Me kërkesën e Drejtorisë Komunale për Shëndetësi, është marr vendim për blerjen e një kombi busi për nevojat e shërbimeve të dializës pranë QKMF-së me paralogarit prej 40.000 eurove. Kanë kaluar edhe dy kërkesat të kësaj drejtorie, ajo e blerjes së paisjeve medicinale për nevojat e shërbimeve shëndetësore në QKMF, QMF-ve dhe AMF-ve me paralogari 50.000 euro, pastaj konkluzioni për mirëmbajtjen dhe renovimin për të gjitha objektet shëndetësore në vlerë prej 100.000 euro dhe mbështetjes financiare për trajtimin mjekësor të 44 pacientëve me nga 300 euro.

Ekzekutivi lokal në këtë takim ka nxjerr konkluzion për shpalljen e tenderëve për vitin 2014: ndërtimin e terrenit sportiv në Jabllanicë dhe Lubinje e Epërm, Renovimin dhe mirëmbajtjen e objekteve ekzistuese kulturo sportive në Piranë, Furnizimin me rekuizita për shoqëritë kulturo artistike, organizimin e festivaleve tradicionale, hartimin e projekteve për nevojat e DKRS si dhe mbështetja materiale për Klubin e Peshkatarisë “Drini i Bardhë” në shumë prej 300 euro dhe Klubit të karatesë “Komandant Drini” mbështetja materiale për pjesëmarrje në turneun tradicional në Stamboll në shumë prej 1.000 euro.

Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik i lejohet shpallja e tenderit për organizimin e panairit Veshjet kombëtare tradicionale të trojeve shqiptare dhe punimeve të dorës – artizanale, organizimi në fjalë kap shumë prej 20.000 euro, gjithashtu është miratuar edhe përbërja e komisionit 6 anëtarësh për përzgjedhjen e objekteve të vjetra në Qendrën Historike të Prizrenit për meremetimin e fasadave të objekteve të vjetra. Paralogaria për këtë intervenim përfshinë shumë prej 30.000 eurove.

Me propozimin e Zyrës për Komunitete dhe Kthim i është lejuar mbështetja financiare prej 6.000 për shtrimin e një dreke mysafirëve nga shtetet e rajonit që do të jenë prezent në Festivalin multikulturor “Sarski Behar”. Dy familjeve nevojtare të komunitetit boshnjak me nga rreth 3.000 euro do tu ofrohet ndihma për renovim të shtëpive me material ndërtimor.

Qeveria lokale në këtë takim ka aprovuar edhe kërkesat e Drejtorisë për Emergjencë dhe Siguri në marrjen e vendimit për pranimin e më se 20 punëtorëve sezonal (zjarrfikësve) si dhe konkluzionit për furnizim me uniforma verore dhe dimërore për zjarrfikës.

Projekti i EC Ma Ndryshe për monitorimin e transparencës së ekzekutivit do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe përmes ueb-faqes së projektit, ku të gjeturat postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit. Tanimë të gjitha të gjeturat e monitorimit, përfshi komunikatat e rregullta dhe shumë informacione të tjera në lidhje me qeverinë lokale të Prizrenit, Mamushës dhe Prishtinës, publikohen në baza të rregullta në ueb-faqen e projektit, www.online-transparency.org

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj,
Elmedina Baxhaku, Monitoruese
OJQ EC Ma Ndryshe
Rr. Saraqët 5, 20000 Prizren
Perandori Dioklician 14, Kati V (te Qafa), 10000 Prishtinë
www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org
+381 38 224 967 & +381 29 222 771



British Embassy
Pristina

Projekti “Transparenca online e komunave të Prizrenit, Mamushë dhe Prishtinës” përkrahët financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë